



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 28, paragrafi 28.1 dhe nenit 29, paragrafi 29.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikues: 632-24-1744-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-021-121 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-8935; në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 20.08.2025, Zytari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 28, i KPK përcakton se “Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi”;

Neni 29 paragrafi 29.1 i KPK përcakton se “Palët duhet t’i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën”

Me dt.18.08.2025, Menaxheri i kontratës i është drejtuar Zyrës së Prokurimit, me kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës "Ri tender -Furnizim me lule dhe kurora", e lidhur me dt.10.06.2024, me numër identifikues: 632-24-1744-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-021-121 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-8935;

Sipas Menaxherit të kontratës" Ri tender- Furnizim me lule dhe kurora", pasi kryesi i furnizimeve Arbnore Hyla B.I., për arsye personale do të bëj mbylljen e aktivitetit afarist, prandaj ka kërkuar edhe përfundimin e të kontratës në fjalë, pasi ka kaluar / përmbushur 70% të realizimit të furnizimeve.


Andaj, bazuar në nenin 28, paragrafi 28.1 dhe nenin 29, paragrafi 29.1 të KPK, si dhe kërkesën e dt.18.08.2025, të menaxherit të kontratës, do të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Nga sa u tha më lartë, ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 10.06.2024, me numër identifikues: 632-24-1744-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-021-121dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-8935, me titull " Ri tender -Furnizim me lule dhe kurora", ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të furnizimeve Arbnore Hyla B.I, rr."Ismail Qemajli", Gjakovë, do te ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 21.08.2025.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,


Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE/A:	18.08.2025
PËR:	Z.Faton Gutaj, Menaxher i Prokurorimit, Komuna Gjakovë
PËRMES:	Z. Kosovar Alija, Drejtor I Administratës, Komuna Gjakovë
NGA:	Menaxheri i projektit- Z. Kaltrina Domi Rraci
CC:	Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për përfundimin e marrveshjetë kontratës me titull: "Furnizim me lule dhe kurora"

Të nderuar,

Ju njoftoj për përfundimin e marrveshjes të kontratës "Furnizim me lule dhe kurora" e cila ka filluar me datë 10.06.2024 e cila është nënshkruar nga OE dhe Z. Arbnore Hyla, e cila ka bërë kërkes me shkrim shkaqe personale më duhet ta mbyll aktivitetin afarist dhe kam vendosur që të përfundoj kontratë aktive, pasi që veq e ka kaluar 70% të furnizimit (sipas kushtev të kontratës).

Andaj kërkoj që Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës ta mirëkuptoj dhe të bëjë shkëputjen e Kontratës "Furnizim me lule dhe kurora" me numër 632-24-1744-1-2-1, e nënshkruar me datë 10/06/2024 me vlerë 14,207.50 euro.

Ju rekomandoj që të vazhdoni me procedurat për përfundim të Kontratës.

Me respekt
Kaltrina Domi Rraci
Menaxhere e kontratës

Kaltrina Domi

From: Arbnore Hyla <arbnore.hyla@gmail.com>
Sent: Friday, August 1, 2025 11:37 AM
To: Faton Gutaj; Nita Efendia; Kaltrina Domi; Kosovar Alija
Subject: Njoftim për përfundim të kontratës "Furnizim me lula dhe kurora"

Caution! This message was sent from outside your organization.

Të nderuar,

Dëshiroj të ju njoftoj, që me datë 31 gusht 2025, për shkaqe personale më duhet ta mbyll aktivitetin tim afarist dhe kam vendosur që të përfundoj kontratë aktive me ju "Furnizim me lule dhe kurora" me numër 632-24-1744-1-2-1, e nënshkruar me datë 10/06/2024 me vlerë 14,207.50 euro.

Sipas neni 4, paragrafi 4.1 të kontratës, parashihet mundësia dhe ceket "devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është +/-30%", ku konsideroj se përfundimi i kontratës në këtë fazë është i pranueshëm dhe në përputhje me marrëveshjen tonë të nënshkruar.

Deri me tani janë realizuar dhe faturuar 11,612.50 euro , që i bije që 81.75% e vlerës së kontratës është përfunduar.

Ju falënderoj për bashkëpunimin gjatë kohës së zbatimit të kontratës.

P.S: Gjatë këtij muaji mund të bëni porosi për pjesën e mbetur të kontratës. Jam e gatshme të bashkëpunoj për një përmbyllje të rregullt dhe korrekte të kontratës.

Faleminderit për mirëkuptim,

Arbnore Hyla

Arbnore Hyla B.I